



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 310/2022

Datë 08/11/2022

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), nenit 11 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7, 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 (nën paragrafi 1.4) të Rregullores QRK-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK)-Nr.04/2021 dhe Rregulloren (QRK)-Nr.03/2022, si dhe në pajtim me nenin 323 paragrafi 1, nenin 328 paragrafi 1 dhe nenin 330 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-118, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E PËRMBARUESIT PRIVAT

1. **Z. Flamur (Sabit) Curri**, emërohet përmbartues privat për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.
2. Selia e të emëruarit do të jetë e vendosur brenda territorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
3. I emëruari, para caktimit të ditës së fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përmbartuese në pajtim me paragrafin 4 të nenit 331 të Ligjit për Procedurën përmbartimore, është i obliguar që në afat prej 60 ditësh nga dita e dhënies së betimit të ofroj dëshmitë se i plotëson kushtet sipas nenit 332 të Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albulena HAXHIU
Ministër e Drejtësisë

Udhëzimi juridik: Kundër këtij vendimi mund të ngritët konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

Vendimi i dërgohet:

- *Përmbauesit privat të emëruar;*
- *Odës së Përmbauesve Privat;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë;*
- *Publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.*